KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferencë me Media – Java e III-të në terren e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

22 prill 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt Konferencë me Media lidhur me ecurinë e punës në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) më 5 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, tha në Procesin e Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë këto ditë është shtuar intenstiteti i regjistrimeve në terren, ashtu siç ka qenë i parashikuar, ku deri më tani janë regjistruar mbi 530 mijë persona dhe mbi 36% e objekteve.

Numri mestar i intervistave në terren këto ditë është shtatë brenda një dite, që do të thotë se do të jemi në plan dhe në kohë me datën e paraparë të Regjistrimit.

Të gjitha komunitetet janë duke marrë pjesë në Regjistrim, duke përfshirë edhe shumë banorë të Veriut të Kosovës që janë duke u regjistruar.

Tutje, U.d. Kryeshefi Ekzekutiv u bëri thirrje qytetarëve që të shikojnë nëse të dhënat e deklaruara po shkruhen saktë.

Më pas, gjatë konferencës u bë edhe një prezantim nga zv. Ministrja e MPJD, znj. Liza Gashi, rreth regjistrimit dhe monitorimit të të regjistruarve nga diaspora. Ajo tha se që nga kjo javë MPJD do të fillojë një fushatë intensive për sensibilizimin e diasporës. Regjistrimi është mundësuar dhe po vazhdon në dy mënyra, përmes platformës online eDiaspora dhe mënyrës fizike (Formulari S1). Ajo gjithashtu ka deklaruar se deri më tani janë regjistruar mbi 180 mijë persona nga diaspora.